REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 25/17
Datë/Datum. 23.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **(Agjencia Qendrore e Prokurimit)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **(AQP/16/001/111)**

Sa i përket tenderit për **(Furnizim me KARBURANTE)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

HIB PETROL SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magj. Prishtine – Lipjan, HIB Headquarters, Preoc
(Adresa)

Prishtine **10000** *(Vendi)*
(Kodi postar)

049 484 588
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Fatbardh Xhaferi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

tenderat@hibopetrol.com
(Adresa elektronike)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "HIB PETROL" SHPK
SEKTORI I KONTRAKTIMEVE

23/01/2017
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Hapja publike e këtij aktiviteti prokurimi behet me datën 24.01.2017.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja publike e këtij aktiviteti prokurimi behet me datën 24.01.2017.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim pranë AK është bere me datën 19/01/2017 si kopje fizike ndërsa përgjigja e AK është kthyer me datën 20.01.2017 përmes prokurimit elektronik. Te bashkangjitur mund te gjeni një kopje te kërkesës se dorëzuar dhe një kopje te përgjigjes se AK ndaj kërkesës sonë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca

1. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 28

Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Neni 30

Nën-kontraktimi

Tenderuesi duhet të tregojë në tenderin e tij ndonjë pjesë të kontratës që ai ka për qëllim të nënkontraktojë palëve të treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Një indikator i tillë nuk ka efekt mbi detyrimin kontraktual nga tenderuesi në lidhje me autoritetin kontraktues apo të tjerët.

Neni 71

Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

1. Grupi i operatorëve ekonomik mund të dorëzojë ftesë për pjesëmarrje ose një tender. Nga asnjëri grup i tillë nuk kërkohet që të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin; mirëpo, nga grupi i përzgjedhur mund të kërkohet që të bëjë këtë pasi që të epet kontrata në fjalë, për aq sa kjo është e nevojshme, për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës.

2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast të një anëtare merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm, përveç nëse mundet të përcaktohet se pjesëmarrja në disa grupe nuk ka pasur ndonjë efekt substancial në konkurrencë.

3. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.

4. *Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Duke u mbështetur ne kërkesat e FDT – së, neni 6.4 Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, njeherit neni 12.1 Nen kontraktimet dhe gjithashtu te kërkuara ne Aneksin 9 – Lokacioni i pikave te karburantit, ju informojmë se duke u mbështetur ne kërkesat tona për marrjen e deklaratës nen betim te disa pikave ku ka qene e obliguar marrja e nen kontraktimeve dhe si e tille ka qene kriter për përshtatshmërinë e Operatoreve Ekonomik kemi hasur ne refuzim per shkak te monopolit te krijuar nga një ose me shume operator ekonomik për bllokimin e dhënies te dokumenteve te cilat janë obligative për dorëzim. Pas shume negociatave kemi zhbllokuar dhënien e këtyre deklaratave mirëpo ne Mamushe ka qene e pamundur për shkak te dhënies se një Operatori tjetër i cili ne nje forme ose tjetër ka krijuar monopol për atë zone. Pika te tjera ne Mamushe janë jashtë parametrave te kërkuara ne FDT. Duke u mbështetur ne nenin 28 dhe nenin 7 pika 4 te LPP mendojmë se rezulton ne diskriminim territorial. Kriteret e tilla dhe qasja e OE ne transparence dhe ne mos krijimin e monopolit ka dështuar dhe presim nga AK qe monopoli te mos lejohet dhe te korrigjohet distanca deri ne 20 km per zonën e caktuar. Duke u bazuar ne shpenzimet te cilat i ka ajo zone rezulton ne nje vlere minimale ne krahasim me furnizimet e autoriteteve tjera ne Lotin e caktuar.

***MONOPOLI** i jashtëm i krijuar si pasoje e kërkesave jo te qëllimta nga AK-ja por te thjeshta per pjesëmarrje ne aktivitetit e prokurimit te përmasave te tilla ka krijuar nje precedent tjetër ku sipas burimeve tona ne teren (mbështetur ne deklarimet e nen kontraktoreve te shumte me te cilët kemi bashkëpunim te gjate dhe te suksesshëm), një kompani e vetme ka krijuar rrjetën e dy konzorciumeve për pjesëmarrje ne ketë aktivitet edhe ne Lotet tjera edhe pse sipas AK dhe planifikimeve është dashur qe një kompani te konkurrojë vetëm ne 2 Lote. Kjo eshte bere per mos krijimin e Monopolit mirëpo Monopoli veqse është bere dhe është dorëzuar ne zyrat e AQP-se. Deklaratat tona bazohen ne marrjen e deklaratave nen betim dhe krijimit te grupeve nga i njëjti person (kompani) qe qëndron mbrapa këtyre furnizimeve. Monopoli është i dënuar me ligj, si direkt ashtu edhe indirekt. Kriteret e dobëta dhe te thjeshta per kete aktivitet voluminoz kane mundësuar krijimin e këtij monopoli. Kërkesat tona paraprake te prezantuara edhe ne konferencën para kualifikuese edhe ne ankesën e bere ndaj aktivitetit kontraktues per:*

1. *Autorizim Prodhuesit*
2. *Referenca dhe kontrata*
3. *Mjetet transportuese*
4. *Licenca për deponim*

kane qene disa nga kriteret qe nuk paraqesin diskriminim sepse neni 71 i LPP, neni 11.1 i FDT, jep mundësinë e krijimit te grupeve dhe konzorciumeve për plotësimin e kritereve dhe shmangjen e këtij monopoli. Mbështetur ne propozimet tona janë edhe dosja e tenderit te AQP-se 2014 dhe AQP-se 2015 ku ka pasur konkurrencë dhe konzorciume. Ne asnjë moment nuk jemi e vetmja kompani qe mund te posedojmë dokumentacione te kërkesave te lartpërmendura dhe ne asnjë mënyrë nuk është kërkesë monopoliste, mirëpo kriteri i tille krijon konkurrimin ne Lotet e propozuara, konkurrence dinjitoze, prezantimin e kompanive te kapaciteteve administrative, teknike dhe profesionale dhe mos dhënien e mundësisë se prezantimit te kompanisë se njëjtë dhe kapaciteteve te saj ne te gjitha Lotet si prapavije ose prezantim direkt. Nëse informatat e tona për këtë monopol nuk do te merren seriozisht nga AK edhe pse janë totalisht te argumentuara dorëzimet e dosjeve minimum 20 dite para afatit për dorëzimin e ofertave

(gjithnjë bazuar te dhënave te nen kontraktorëve dhe pjesëtareve te konzorciumit) atëherë do te obligohemi qe deklaratat për krijimin e këtij monopoli t'i dorëzojmë ne Krimet Ekonomike dhe institucionet përgjegjëse tjera te Republikës se Kosovës.

Kompania HIB Petrol mbështetur ne argumentet e ofruara kërkon nga AK qe te :

- *Anulojë procedurën e këtij aktiviteti;*

Analizoje dhe vendose kritere te cilat ne asnjë mënyrë nuk do te lejonin krijimin e monopolit direkt apo indirekt ne interes te transparencës dhe konkurrencës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e imazhit te kompanisë ne konkurrencës jo lojale dhe monopoliste.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*